



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, nxjerr këtë:

URDHËRESË

- I. **NDALOHET** qarkullimi i të gjitha automjeteve, përveç autobusëve të NPL “Trafiku Urban”, linja 4, automjeteve të Policisë së Kosovës, të KFOR-it, të EULEX-it, të ndërmarrjes “Hortikultura”, të KRM “Pastrimi”, të Drejtorisë së Inspektionit dhe automjeteve emergjente, më 1 Maj 2023 për nder të Ditës Ndërkombëtare të Punës-1 Maji, në drejtim të parkut “Gërmia”, ndërsa linja 5 e transportit publik do të punoj sipas itinerarit dhe orarit të rregullt deri në Sofali.
- II. Pika përfundimtare për lëvizjen e automjeteve, përveç banorëve të lagjeve: “Normale”, “Sofalia”, “Tauk- Bahçe” dhe restoranteve- villat: “Gërmia”, “Freskia”, dhe “Soma” do të jetë:
 - Kryqëzimi i rrugëve “1 Tetori” - “Nazim Gafurri” dhe “Ymer Lutfi Paqarizi”,
 - Kryqëzimi i rrugëve “Nazim Gafurri” - “Xhavit Ahmeti” dhe “Dr. Lec Gradica”,
 - Kryqëzimi i rrugëve “Shpëtim Robaj” me atë të Sofalis, në drejtim të pishinës dhe parkut “Gërmia”.
- III. Transporti publik i qytetarëve për në parkun “Gërmia” deri te pishina, do të bëhet ekskluzivisht me autobus të NPL “Trafiku Urban”, linja 4.
- IV. Inspektorët përgjegjës të Drejtorisë së Inspektionit, për datën e cekur në pikën I të urdhëresës, do të :
 - Parandalojnë shërbyesit e paautorizuar që të bëjnë shitjen – shërbimin ndaj qytetarëve;
 - Organizojnë kujdestari, me qëllim të ruajtjes së ambientit (përdorimin e zjarreve për destinime të ndryshme) si dhe hedhjen e mbeturinave në vende të caktuara.
- V. Zyra për marrëdhënie me publikun do t’i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.

VI. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U DORËZOHET:

- NPL "Trafiku Urban", linja 4 dhe 5;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

